



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 korrik 2024
Nr. ref.: RK 2482/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI52/24

Parashtrues

Shkelzen Zariqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Pml.nr.446/2023] të 29 nëntorit
2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shkelzen Zariqi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Artan Qerkini, nga Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” SH.P.K., Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 446/2023] të 29 nëntorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [APS. nr. 9/2023] e 19 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PS. Nr. 56/2020] të 28 tetorit 2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Pml. nr. 446/2023] të 29 nëntorit 2023, të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe të rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 shkurt 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 mars 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI52/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues, ndërkaq përmes Vendimit [Nr. KSH.KI52/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç’ rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
8. Më 2 prill 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

10. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 22 dhjetor 2020, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Speciale) kishte ngritur Aktakuzën [PPS. nr. 50/2020] kundër parashtruesit të kërkesës dhe 3 (tre) personave tjerë, përkatësisht A.A., B.K. dhe V.R., për veprën penale “Detyrimi” e mbetur në tentativë, nga paragrafi 2 i nenit 267 lidhur me nenin 1 dhe nenin 20 të Kodit R.2003/25 të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK). Sipas aktakuzës, të pandehurit, më 25 maj 2010 dhe më 7 shtator 2010, duke vepruar si anëtarë të grupit dhe me qëllim që t’i sjellin vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, përmes kërcënimit të rëndë, kishin tentuar të detyronin të dëmtuarin H.K., që të veprojë në dëm të pasurisë së tij dhe të tërhiqet nga prona e tij në fshatin Milloshevë, e privatizuar në valën e 34 të privatizimit.
12. Më 28 tetor 2022, Gjykata Themelore përmes aktgjykimit [PS. nr. 56/2020] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të lartcekur, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi i kërkesës së bashku me B.K., i kishin premtuar A.A. ndërtimin e shtëpisë dhe dhënien e një shume të parave, në këmbim të kërcënimit me granata dore dhe bombola gazi në pronën e të dëmtuarit H.K., me qëllim që ky i fundit të tërhiqej nga prona e privatizuar.
13. Më tej, Gjykata Themelore në arsyetimin e aktgjykimit të saj vlerësoi se nga provat e administruara, vërtetohej se parashtruesi i kërkesës me të pandehurit e tjerë kishin vepruar si grup duke theksuar si në vijim:
“Pra, marrë në konsideratë faktin se në rastin konkret kemi të përfshirë tre persona (të akuzuarit: [B.K.], [SH.Z.] e [A.A.]), gjykata konsideron se është përmbushur kushti i krijimit apo ekzistimit të grupit prej tre e më shumë persona dhe të cilët i lidh një interes i përbashkët ai i detyrimit të të dëmtuarit [H.K.] që të tërhiqet nga prona e tij e privatizuar në dëm të tij e në interes të të akuzuarve [B.K.] e [SH.Z.], ndërsa në interes të të akuzuarit [A.A.] që ati ndërtohet një shtëpi dhe ti jepet shumë e caktuar e parave për të vendosur bombat në pronën e të dëmtuarit [H.K.]. Gjykata, përfundimisht nga këto rrethana e të cilat janë provuar me dëshmitë e administruara në këtë proces gjyqësor, vije në përfundim/Konkludim se në rastin konkret të akuzuarit kanë vepruar në cilësi të grupit.”
14. Në lidhje me gjuhën ligjore të paragrafit 2 të nenit 267 të KPPK-së, që parasheh veprën penale “Detyrimi”, Gjykata Themelore theksoi se kjo dispozitë kërkon që vepra penale të kryhet si anëtar i grupit dhe jo i grupit të organizuar kriminal e as i krimit të organizuar si dhe kërkohet që të jetë përdorur mjeti i rrezikshëm, e që në rastin konkret, sipas Gjykatës Themelore, është plotësuar, pasi që janë përdorur granata dore dhe bombola gazi.
15. Gjykata Themelore konstatoi faktin që parashtruesi i kërkesës së bashku me të pandehurin B.K., kishin porositur të pandehurin A.A. për vendosjen e granatave në pronën e të dëmtuarit H.K., bazuar në dëshminë e këtij të fundit, audio-incizimin ndërmjet të dëmtuarit dhe të pandehurit A.A. dhe dëshminë e dëshmitarëve Z.B. dhe B.D.
16. Më konkretisht, në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore, duke iu referuar deklaratës së të dëmtuarit, theksoi si në vijim “*[H.K.] në këtë çështje penale ka*

deklaruar/potencuar se “në vitin 2017-2018, ka qenë takimi i parë me [A.A], [...] dhe [A.A] ka deklaruar se unë jam i shtyer prej [SH.Z] i pari dhe një [B.K] i Malishevës dhe nga [Sh.Z] i është premtuar ndërtimi i shtëpisë dhe shuma prej 12.000 Euro”. Nga kjo pjesë e deklaratës së të dëmtuarit shihet qartë se porositës të këtij detyrimi kanë qenë të akuzuarit [B.K] dhe [SH.Z].”

17. Tutje, Gjykata Themelore e vlerësoi si provë të ligjshme audio-incizimin ku i pandehuri A.A pranon se parashtruesi i kërkesës e ka porositur atë që të vendosë granatat e dorës tek prona e të dëmtuarit, me arsyetimin se dispozitat e KPPK-së janë të detyrueshme për organet e ndjekjes penale, organet e drejtësisë dhe organet publike të cilat marrin pjesë në procedurë penale por jo edhe për qytetarin e thjeshtë, të dëmtuar nga vepra penale. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore konstatoi se i dëmtuari nuk ka qenë i obliguar që të marrë leje nga gjykata për zbatimin e masave të fshehta.

18. Përmes aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Themelore theksoi se dëshmia e të dëmtuarit H.K., lidhur me faktin se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar vendosjen e granatave të dorës në pronën e tij përputhej me dëshminë e dëshmitarit Z.B. Në këtë kontekst, në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore u specifikua si në vijim:

“Ky dëshmitar në deklaratimet e tija, ka theksuar se për rastin e granatave të dorës ka pasur njohuri që nga viti 2010, mirëpo nuk është interesuar shumë për këtë çështje dhe se është njoftuar për këto granata nga [SH.Z], ku nga [SH.Z] i është kërkuar që të shkoj në polici dhe të jep deklaratë.

[...]

Dëshmitari [Z.B], ka theksuar se [A.A] (i akuzuari) në takim e ka pranuar se [SH.Z] i ka thënë “që është me një shok të tij në një tender, por emrin nuk i ka përmendur, këta i kanë kërkuar për ti vendosur granatat e dorës në pronën e të dëmtuarit, për me kry qet punë se nuk është njeri jo i mirë”, ndërsa i akuzuari [A.A] të merr si kompensim një shumë parash dhe ndërtimin e shtëpisë.”

19. Përkitazi me motivin për kryerjen e veprës penale, Gjykata Themelore arsyetoi si në vijim:

“Të gjitha këto prova të administruara, pohime të dëshmitarëve vënë në pah pa asnjë mëdyshje faktin se privatizimi i pronës në fshatin Milloshevë ka ndodhur, se ka pasur marrëveshje ndër të tjerë edhe ndërmjet të akuzuarit [B.K] e të dëmtuarit [H.K] dhe se granatat e dorës janë vendosur në pronën e të dëmtuarit me kërkesën e të akuzuarin [SH.Z] e të akuzuarit [B.K]. Motivi i vendosjes, apo arsyeja e vendosjes së këtyre granatave është detyrimi i të dëmtuarit [H.K] që të tërhiqet nga prona e privatizuar në dëm të tij e në interes të të akuzuarit [SH.Z] e të akuzuarit [B.K], ndërsa në interes të të akuzuarit [A.A], që ti jepet si kompensim i vendosjes së granatave një shumë parash e t'i ndërtohet shtëpia.”

20. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Speciale parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [PS. nr. 56/2020] të 28 tetorit 2022 të Gjykatës Themelore, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarve t'u shqiptojë dënim me burgim me kohë më të gjatë.

21. Më 19 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin.

22. Më 19 prill 2023, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [APS. nr. 9/2023] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe Prokurorisë Speciale dhe vërtetoi Aktgjykimin [PS. nr. 56/2020] e 28 tetorit 2022 të Gjykatës Themelore.
23. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përmes aktgjykimit të lartcekur, Gjykata e Apelit vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase dispozitivi i aktgjykimit ishte i qartë, i kuptueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyetimin si dhe ishin paraqitur arsytet për çdo pikë të aktgjykimit. Më tej, pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar me arsyetimin se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarit, gjykata e shkallës së parë drejtë kishte ardhur në konkludimin se vendosja e granatave të dorës ishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës. Në lidhje me këtë, në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, u theksua si në vijim:

“Në shqyrtim gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë [H.K] ka deklaruar se “në vitin 2017-2018, ka qenë takimi i parë me [A.A], kur në tavolinë ma kanë sjellë [A.A], [Z.B] me [V.R] dhe ishte mbrëmje kur ka hy [A.A] brenda në një restaurant në Breg të Diellit dhe ka ardhur drejt në tavolinë tek ne dhe është ulur në tavolinë aty. [Z.B] më ka thënë se ky është personi [A.A] dhe është personi që ti ka gjujt bombën dhe [A.A] ka qenë aty prezent dhe unë ju kam kthy dhe e kam pyet [A.A] se a po më njeh dhe [A.A] është përgjigjur se jo dhe unë e kam pyetur atëherë pse mi keni gjuajtur bombat ju mua, çka ju kam bërë unë juve, i njëjti mu ka përgjigj se më kanë bindur, më kanë shtie që ti je një njeri shumë i rrezikshëm UDB dhe bënë shumë keq Kosovës, edhe [A.A] ka deklaruar se unë jam i shtyer prej [SH.Z] i pari dhe një [B.K] i Malishevës dhe nga [SH.Z] i është premtuar ndërtimi i shtëpisë dhe shuma prej 12.000 Euro.

Kolegji gjen se edhe nga provat tjera është vërtetuar se porositës kanë qenë të akuzuarit [SH.Z] dhe [B.K], dhe atë nga audioincizimi i kontaktit të të dëmtuarit [H.K] me të akuzuarin [A.A], ku i akuzuari [A.A] e potencon vet personalisht në audio-incizim se nga ai i është kërkuar që të vendosen granata në pronën e të dëmtuarit dhe atë është kërkuar nga [SH.Z] e njëfarë [B.K] i Malishevës, ashtu si thekson [A.A]. [...]

Pra, kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë nga të gjitha faktet e potencuara nga dëshmitarët e poashtu edhe ato të potencuar në video e audio incizim të deklarimeve të [A.A], drejtë ka ardhur në përfundim se porositësit ishin [B.K] e [SH.Z] dhe se me porosinë e këtyre të dyve i akuzuari [A.A] i ka vendosur granatat e dorës. Këto fakte gjykata i ka vërtetuar nga shkresat e lëndës si tërësi, por posaçërisht nga deklarimi i të dëmtuarit [H.K], dëshmitarëve [Z.B] e [B.D], si dhe nga deklarimi i të akuzuarit [A.A] se i ka vendosur granatat me kërkesën e [SH.Z] dhe njëfarë [B.K] nga Malisheva.”

24. Përmes aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjykata e shkallës së parë ishte bazuar vetëm në deklaratën e të akuzuarit A.A., duke theksuar se “Kolegji penal pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se [B.K] e [SH.Z], kanë angazhuar të akuzuarin [A.A] në vendosjen e granatave të dorës e bombolave të gazit, këtë gjykata e ka vërtetuar nga deklaratimet e dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje penale dhe nga administrimi i provave materiale. [...]

25. Ndërkaq, pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal dhe pretendimin lidhur me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuar me arsyetimin se veprimet e parashtruesit të kërkesës përbënin të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale “Detyrimi”, në tentativë, nga paragrafi 2 i nenit 267 lidhur me nenin 1 dhe nenin 20 të KPPK-së dhe se dënimet e shqiptuara ndaj parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve tjerë, ishin në përputhje me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore, shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e pasojave të shkaktuara.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [APS. nr. 9/2023] të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, me arsyetimin se ekzistonin rrethana që përjashtonin përgjegjësinë e tij penale dhe për shkak të vendimit mbi dënimin.
27. Më 29 nëntor 2023, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml.nr.446/2023] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe (ii) aprovoi pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të pandehurit A.A. Gjykata Supreme vlerësoi se (i) aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë nuk ishin të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) se ishin dhënë arsye të mjaftueshme për provat mbi bazën e të cilave ishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës dhe të pandehurit e tjerë kishin kryer veprën penale në fjalë; (iii) se veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve B.K dhe A.A., përbënin të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Detyrimi” mbetur në tentativë; (iv) se Gjykata Themelore i kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në shqiptimin e dënimin për parashtruesin e kërkesës; dhe se (v) arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore përmbante analizë të hollësishme të çështjeve siç ishin “grupi”, “mjeti i rrezikshëm”, “tentativa” dhe “motivi”.
28. Gjykata Supreme, në arsyetimin e aktgjykimit të saj, konstatoi se deklarata e të pandehurit A.A., nuk ishte e vetmja provë mbi të cilën ishte zgjidhur çështja penale. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme theksoi si në vijim:

“Nga aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, por edhe nga shkresat tjera të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se mbrojtja e të dënuarit [A.A.] nuk ka qenë e vetmja provë mbi bazën e të cilës është vendosur që të zgjidhet kjo çështje juridike penale. Përkundrazi, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë rast gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar një numër i konsideruar i provave të propozuara nga palët, siç janë: raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, pas hedhjes së granatave të dorës dhe bombolave të gazit në datat 25.05.2010 dhe 07.09.2010, në zyrat e kompanisë së të dëmtuarit; fotot nga vendi i ngjarjes; provat tjera materiale siç janë: dokumentet e ndryshme, regjistrat, marrëveshjet, fletë-deponimet, vërtetimet, etj.; deklaratimet e të dëmtuarit [H.K], deklaratimet e dëshmitarëve [B.D] dhe [Z.B], etj. Gjithashtu, në këtë aspekt, është e rëndësishme të potencohen edhe video-incizimet e emisionit “Biznesi i Bombave” i “Kallxo.com”, si dhe audio-incizimi i bërë nga i dëmtuari [H.K], të cilat janë administruar si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor [...]”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si

rezultat i (i) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor; (ii) interpretimit qartazi arbitrar të ligjit; dhe (iii) shqyrtimit jo të duhur dhe jo të plotë të rastit.

(i) *Lidhur me pretendimin për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor*

30. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe Gjykatës, e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor është e lidhur ngushtë me administrimin e duhur të drejtësisë dhe se vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës shton se është e domosdoshme që vendimet e gjykatave t'i paraqesin në mënyrë të plotë dhe të qartë arsyet në të cilat ato bazohen.
31. Në mbështetje të pretendimit për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës [KI138/15](#), ku kjo e fundit kishte vlerësuar se mungesa e adresimit të plotë të pretendimeve bazike të parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës Supreme dhe gjykatave të instancës më të ulët përbënte një të metë të pakapërcyeshme (shih, rastin e Gjykatës [KI138/15](#), parashtrues “*Sharr Beteiligungs GmbH*” SH.P.K, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017). Parashtruesi i kërkesës shton se një shkelje e tillë e të drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor ka ndodhur në rastin e tij për faktin se Gjykata Supreme nuk ka adresuar shumicën e pretendimeve të tij dhe se në aktgjykimet e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore mungon ndërlidhja ndërmjet fakteve të (pa) vërtetuara të rastit dhe dispozitave ligjore.
32. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të dorëzuar në Gjykatën Supreme dhe në ankesën në Gjykatën e Apelit, kishte paraqitur pretendimet si në vijim (i) deklarata e të pandehurit A.A., ishte marrë si provë kundër parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së; (ii) i bashkëpandehuri A.A. kishte dhënë deklarata kundërtënëse në polici; (iii) përgjegjësia penale e parashtruesit të kërkesës ishte bazuar tërësisht në deklaratat e të bashkëpandehurve dhe personave tjerë që kanë përfituar nga privatizimi; (iv) ishte shpërfillur fakti se inkriminimi i parashtruesit të kërkesës ishte bërë nga Z.B., i cili sapo kishte dalë nga burgu; (v) parashtruesi i kërkesës kishte marrë pjesë në procesin e privatizimit mirëpo ishte larguar nga ai proces para se të kryhej vepra penale, për shkak të kontestit me B.K.; dhe (vi) gjykatat e shkallës më të ulët nuk kanë vërtetuar motivin dhe përfitimin e parashtruesit të kërkesës dhe është shpallur fajtor si pjesëtar i një grupi (kriminal).
33. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se nga 6 (gjashtë) pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme ka adresuar sipërfaqësisht vetëm pretendimin lidhur me marrjen si provë të deklaratës së të pandehurit A.A., si dhe pretendimin lidhur me konstatimin e gabuar se parashtruesi i kërkesës ishte pjesë e grupit, mirëpo i njëjti nuk është elaboruar. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se nuk e ka trajtuar në thelb pretendimin e parashtruesit të kërkesës që sipas KPPK-së nuk ka qenë e lejuar që të pranohet si provë deklarata e të bashkëpandehurit, në rastin konkret e A.A., kundër të bashkëpandehurve të tjerë, dhe sipas parashtruesit të kërkesës “Gjykata Supreme është mjaftuar duke arsyetuar se “*mbrojtja e të dënuarit A.A nuk ka qenë e vetmja provë mbi bazën e të cilës është vendosur të zgjidhet kjo çështje juridike penale.*”
34. Më tej, parashtruesi i kërkesës shton se as Gjykata Supreme dhe as gjykatat e shkallës më të ulët nuk kanë paraqitur ndërlidhje logjike ndërmjet fakteve të rastit dhe interpretimit të ligjeve penale. Në këtë drejtim, ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat

kanë dështuar të vërtetojnë lidhjen në mes të veprës penale dhe interesit të tij për të marrë pjesë në atë ngjarje kriminale dhe për t'u bërë pjesë e grupit kriminal, nuk është vërtetuar se i njëjti ka pasur motiv apo interes për t'u përfshirë në kryerjen e një veprë të tillë penale, nuk është vërtetuar në mënyrë bindëse se ka qenë pjesë e grupit dhe nuk është analizuar interesi i Z.B., për të inkriminuar parashtruesin e kërkesës. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se edhe pse Gjykata, si rregull, nuk trajton aspektet faktike të rastit, një obligim i tillë ekziston kur gjykatat e rregullta nuk arsyetojnë lidhshmërinë në mes fakteve të rastit dhe interpretimit të ligjit.

(ii) *Lidhur me pretendimin për interpretim arbitrar të ligjit*

35. Në lidhje me pretendimin për interpretim arbitrar të ligjit, parashtruesi i kërkesës thekson se edhe pse nuk është detyrë e Gjykatës që të merret me pretendimet për interpretim të gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, ajo duhet të ndërhyjë kur konstaton se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” për parashtruesin e kërkesës. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve të GJEDNJ-së [Anheuser-Busch Inc., kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83, [Soutransavto kundër Ukrainës](#), nr. 48553/99, Aktgjykim i 6 nëntorit 2002, paragrafët 79-97 dhe 98, dhe rasteve të Gjykatës, [KI06/17](#), parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2017, paragrafi 40 dhe [KI122/16](#), parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 59.
36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka interpretuar në mënyrë të gabuar dhe qartazi arbitrare paragrafin 5 të nenit 123 (Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë) të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (GZ. numër 37, 28 dhjetor 2012) (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK), pasi që kjo dispozitë nuk lejon që të merret si provë deklarata e të pandehurit A.A., kundër tij, provë e cila sipas tij ka qenë provë fajësuese vendimtare kundër tij.
37. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore ka interpretuar gabimisht ligjin kur konstatoi se parashtruesi i kërkesës dhe dy të pandehurit e tjerë kishin vepruar në cilësi të grupit- si anëtarë të grupit. Sipas parashtruesit të kërkesës, “gjykatat nuk kanë bërë dallim në mes të “grupit kriminal” (neni 277 i KPK) dhe “bashkimit kriminal” (neni 34 i KPK)”. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës shton se përveç që gjykatat nuk kanë bërë dallimin ndërmjet këtyre dy veprave penale, ato nuk kanë elaboruar ekzistimin e elementeve të asnjërës nga këto vepra penale, “ndërkohë që kanë arsyetuar paqartë se parashtruesi i kërkesës dhe të bashkëpandehurit tjerë kanë vepruar “si grup”.
38. Parashtruesi i kërkesës thekson se duke lejuar interpretimin qartazi të gabuar të ligjit, në dëm të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme i ka mohuar parashtruesit të kërkesës mbrojtjen nga interpretimi qartazi arbitrar i ligjit, si një nga garancitë themelore procedurale në kuadër të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

(iii) *Lidhur me pretendimin për mos-shqyrtim të duhur dhe të plotë të rastit*

39. Parashtruesi i kërkesës, duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se e drejta për shqyrtim të duhur dhe të plotë të rastit bën pjesë në një nga garancitë procedurale në kuadër të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës i referohet në veçanti rastit

të GJEDNJ-së [Dulaurans kundër Francës](#), për të cilin shton se si rezultat i mos-shqyrtimit të duhur dhe të plotë të rastit nga ana e Gjykatës së Kasacionit në Francë, respektivisht mungesës së kujdesit të gjykatës në shqyrtimin e argumenteve dhe provave të palës, GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Dulaurans kundër Francës](#), nr. 34553/97, Aktgjykim i 21 marsit 2000, paragrafi 33).

40. Sipas parashtruesit të kërkesës, e drejta për shqyrtim të duhur dhe të plotë të rastit, si komponentë e re e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, i mbron palët nga neglizhenca dhe shkujdesja e gjykatave. Mbështetur në këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se, në rastin e tij, të tri shkallët e gjyqësorit të rregullt nuk kanë treguar kujdesin e duhur duke i trajtuar në mënyrë grupore dhe shabllone pretendimet e të bashkëpandehurve. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit i kanë trajtuar të grupuara të gjitha pretendimet e tij dhe 3 (tre) të akuzuarve të tjerë, duke mos i trajtuar pretendimet dhe argumentet e tij që kanë qenë ndryshe nga pretendimet e tyre.
41. Më tej, parashtruesi i kërkesës shton se si rezultat i shkujdesjes nga ana e gjykatave të rregullta nuk janë zbardhur fakte qenësore të rastit siç janë deklaratat kundërthënëse të të bashkëpandehurit A.A., faljen e besimit në dëshminë e një dëshmitari me kredibilitet të ulët, i cili sapo kishte dalë nga burgu, mos-elaborimin e kriterëve ligjore për (mos) ekzistimin e grupit kriminal dhe aspekte të tjera të rëndësishme të rastit. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se përderisa Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë marrë parasysh si provë emisionin televiziv “Biznesi i Bombave” i “Kallxo.com”, që sipas tij zbeh seriozitetin e një procesi gjyqësor, ndërsa pretendimet dhe argumentet tij të lartcekura nuk janë adresuar fare.
42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme ka miratuar vendimet e gabuara të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, duke mos-korrigjuar shkeljet kushtetuese që janë bërë ndaj tij dhe duke rezultuar me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
43. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të shpallë kërkesën e tij të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktgjykimi [Pml. nr. 446/2023] i 29 nëntorit 2023, i Gjykatës Supreme, shkel nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml. r. 446/2023] e Gjykatës Supreme, Aktgjykimin [APS. nr. 9/2023] e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PS. nr. 56/2020] e Gjykatës Themelore; si dhe (iv) të kthejë çështjen për rivendosje në Gjykatën Themelore, në pajtim me konstatimet e Gjykatës.

DISPOZITAT PËRKATËSE KUSHTETUESE DHE LIGJORE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]*”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]*”

KODI R.2003/25 I PËRKOHSHËM PENAL I KOSOVËS

Neni 20 (Tentativa)

“[...]

(2) Tentativa për kryerjen e një veprë penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet, kurse lidhur me veprat e tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë”.

Neni 267 (Detyrimi)

“(1) Kushdo i cili me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme përdor forcën apo kërcënimin e rëndë për ta detyruar personin tjetër që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së vet a të pasurisë së personit tjetër dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit duke përdorur ndonjë armë ose mjet të rrezikshëm apo rezulton me dobi të madhe pasurore, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet”.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS

Neni 123

(Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklaratat në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë)

[...]

(5) Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

44. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
45. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

46. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

[...]

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

47. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 446/2023] e 29 nëntorit 2023, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkëlur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
48. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, paragrafi (2) i rregullit 34 përcakton:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
49. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
50. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e Gjykatës [KIo4/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 26; dhe [Kl107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 tetorit 2021, paragrafi 53).
51. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
52. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me faktin se Gjykata Themelore kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale “Detyrimi” e mbetur në tentativë, nga paragrafi 2 i nenit 267 lidhur me nenin 1 dhe nenin 20 të KPPK-së. Përmes këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me dënim prej 3 (tre) viteve burgim pasi që konstatoi se parashtruesi i kërkesës së bashku me B.K., i kishin premtuar A.A. ndërtimin e shtëpisë dhe dhënien e një shume të parave në këmbim të kërcënimit me

granata dore dhe bombola gazi në pronën e të dëmtuarit. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesë dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit, të cilën kjo e fundit e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarit, gjykata e shkallës së parë drejtë kishte ardhur në konkludimin se kryerja e veprës penale ishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës. Më pas, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme, kërkesë e cila u refuzua si e pabazuar.

53. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e mësipërme të Gjykatës Supreme dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, me pretendimin se përmes aktgjykimeve të tyre atij i është shkëllur e drejta e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, interpretimit qartazi arbitrar të ligjit dhe mos-shqyrtimit të duhur dhe të plotë të rastit.
54. Gjykata fillimisht thekson se meqenëse pretendimi i parashtruesit të kërkesës për mos-shqyrtim të duhur dhe të plotë të rastit, në thelb, ndërlidhet me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, të njëjtin do ta trajtojë në kuadër të pretendimit për mosarsyetim të vendimit gjyqësor. Rrjedhimisht, Gjykata, në vijim, do të vlerësojë (i) pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, duke vazhduar më pas me vlerësimin e (ii) pretendimit për interpretim qartazi arbitrar të ligjit.

(i) Lidhur me pretendimin për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor

Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor

55. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 20124/92, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; si dhe rastet e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022; dhe [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).
56. Në parim, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI143/22](#), cituar më lart, paragrafi 116).
57. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e

dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, rastet e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 29; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 42; dhe shih rastet e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 48).

58. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët (shih, rastin e GEJDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih, rastet e GJEDNJ-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 30).
59. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur se edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtrësive të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsyet për vendimet e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 36).
60. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument, argumentet thelbësore të parashtrësive të kërkesës duhet të adresohen (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 61; dhe [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005, paragrafi 63).
61. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Vendimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih, rastet e Gjykatës [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012, paragrafi 61 dhe [KI97/16](#), *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 52).

Zbatimi i parimeve të lartcekura

62. Në këtë kontest, Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesi i kërkesës thekson se në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të dorëzuar në Gjykatën Supreme dhe në ankesën në Gjykatën e Apelit, kishte paraqitur pretendimet si në vijim (i) deklarata e të pandehurit A.A., ishte marrë si provë kundër parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së; (ii) i bashkëpandehuri A.A., kishte dhënë deklarata kundërthënëse në polici; (iii) përgjegjësia penale e parashtruesit të kërkesës ishte bazuar tërësisht në deklaratat e të bashkëpandehurve dhe personave tjerë që kanë përfituar nga privatizimi; (iv) ishte shpërfillur fakti se inkriminimi i parashtruesit të kërkesës ishte bërë nga Z.B., i cili sapo kishte dalë nga burgu; (v) parashtruesi i kërkesës kishte marrë pjesë në procesin e privatizimit mirëpo ishte larguar nga ai proces para se të kryhej vepra penale, për shkak të kontestit me B.K.; dhe (vi) gjykatat e shkallës më të ulët nuk kanë vërtetuar motivin dhe përfitimin e parashtruesit të kërkesës dhe është shpallur fajtor si pjesëtar i një grupi (kriminal). Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme ka adresuar sipërfaqësisht vetëm pretendimin lidhur me marrjen si provë të deklaratës së të bashkëpandehurit A.A. dhe pretendimin lidhur me konstatimin e gabuar se parashtruesi i kërkesës ishte pjesë e grupit, mirëpo i njëjti nuk është elaboruar.

63. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se të tri shkallët e gjyqësorit të rregullt, e në veçanti Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit, nuk kanë treguar kujdesin e duhur duke i trajtuar në mënyrë grupore dhe shabllone pretendimet e të bashkëpandehurve, duke rezultuar në mungesën e zbardhjes së fakteve qenësore të rastit siç janë deklaratat kundërthënëse të të bashkëpandehurit A.A., faljen e besimit në dëshminë e një dëshmitari me kredibilitet të ulët i cili sapo kishte dalë nga burgu, mos-elaborimin e kriterëve ligjore për (mos) ekzistimin e grupit kriminal dhe pranimit si provë të një emisioni televiziv.
64. Në ndërlidhje me çështjet e lartcekura, Gjykata në vazhdim do t'u referohet pjesëve relevante të vendimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Fillimisht, Gjykata i referohet Aktgjykimit [PS. nr. 56/2020] të Gjykatës Themelore, e cila ekzistimin e grupit e ka arsyetuar si në vijim:

“Pra, marrë në konsideratë faktin se në rastin konkret kemi të përfshirë tre persona (të akuzuarit: [B.K.], [SH.Z.] e [A.A.]), gjykata konsideron se është përmbushur kushti i krijimit apo ekzistimit të grupit prej tre e më shumë persona dhe të cilët i lidh një interes i përbashkët ai i detyrimit të të dëmtuarit [H.K.] që të tërhiqet nga prona e tij e privatizuar në dëm të tij e në interes të të akuzuarve [B.K.] e [SH.Z.], ndërsa në interes të të akuzuarit [A.A.] që ati ndërtohet një shtëpi dhe ti jepet shumë e caktuar e parave për të vendosur bombat në pronën e të dëmtuarit [H.K.]. Gjykata, përfundimisht nga këto rrethana e të cilat janë provuar me dëshmitë e administruara në këtë proces gjyqësor, vije në përfundim/Konkludim se në rastin konkret të akuzuarit kanë vepruar në cilësi të grupit.”

65. Në vijim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore erdhi në përfundim që parashtruesi i kërkesës kishte porositur të pandehurin A.A., për vendosjen e granatave në pronën e të të dëmtuarit H.K., nga (i) deklarata e të dëmtuarit; (ii) audio-incizimi ndërmjet të dëmtuarit dhe të pandehurit A.A., ku ky i fundit deklaroi se ka vepruar në bazë të kërkesës së parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit B.K.; dhe (iii) dëshmisë së dëshmitarëve Z.B. dhe B.D.
66. Ndërkaq, lidhur me motivin që parashtruesi i kërkesës dhe të bashkëpandehurit e tjerë kishin për kryerjen e veprës penale në fjalë, në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore u theksua si në vijim:

“Të gjitha këto prova të administruara, pohime të dëshmitarëve vënë në pah pa asnjë mëdyshje faktin se privatizimi i pronës në fshatin Milloshevë ka ndodhur, se ka pasur marrëveshje ndër të tjerë edhe ndërmjet të akuzuarit [B.K.] e të dëmtuarit [H.K.] dhe se granatat e dorës janë vendosur në pronën e të dëmtuarit me kërkesën e të akuzuarit [SH.Z.] e të akuzuarit [B.K.]. Motivi i vendosjes, apo arsyeja e vendosjes së këtyre granatave është detyrimi i të dëmtuarit [H.K.] që të tërhiqet nga prona e privatizuar në dëm të tij e në interes të të akuzuarit [SH.Z.] e të akuzuarit [B.K.], ndërsa në interes të të akuzuarit [A.A.], që ti jepet si kompensim i vendosjes së granatave një shumë parash e t'i ndërtohet shtëpia.”

67. Gjykata më tutje i referohet Aktgjykimit [APS. nr. 9/2023] të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi si në vijim:

“Në shqyrtim gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë [H.K.] ka deklaruar se “në vitin 2017-2018, ka qenë takimi i parë me [A.A.], kur në tavolinë ma kanë sjellë [A.A.], [Z.B.] me [V.R.] dhe ishte mbrëmje kur ka hy [A.A.] brenda në një restaurant në Breg të Diellit dhe

ka ardhur drejt në tavolinë tek ne dhe është ulur në tavolinë aty. [Z.B] më ka thënë se ky është personi [A.A] dhe është personi që ti ka gjujt bombën dhe [A.A] ka qenë aty prezent dhe unë ju kam kthyer dhe e kam pyetur [A.A] se a po më njeh dhe [A.A] është përgjigjur se jo dhe unë e kam pyetur atëherë pse mi keni gjuajtur bombat ju mua, çka ju kam bërë unë juve, i njëjti mu ka përgjigjur se më kanë bindur, më kanë shtie që ti je një njeri shumë i rrezikshëm UDB dhe bënë shumë keq Kosovës, edhe [A.A] ka deklaruar se unë jam i shtyer prej [SH.Z] i pari dhe një [B.K] i Malishevës dhe nga [SH.Z] i është premtuar ndërtimi i shtëpisë dhe shuma prej 12.000 Euro.

Kolegji gjen se edhe nga provat tjera është vërtetuar se porositës kanë qenë të akuzuarit [SH.Z] dhe [B.K], dhe atë nga audioincizimi i kontaktit të të dëmtuarit [H.K] me të akuzuarin [A.A], ku i akuzuari [A.A] e potencon vet personalisht në audio-incizim se nga ai i është kërkuar që të vendosen granata në pronën e të dëmtuarit dhe atë është kërkuar nga [SH.Z] e njëfarë [B.K] i Malishevës, ashtu si thekson [A.A]. [...]

Pra, kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë nga të gjitha faktet e potencuara nga dëshmitarët e poashtu edhe ato të potencuar në video e audio incizim të deklarimeve të [A.A], drejtë ka ardhur në përfundim se porositësit ishin [B.K] e [SH.Z] dhe se me porosinë e këtyre të dyve i akuzuari [A.A] i ka vendosur granatat e dorës. Këto fakte gjykata i ka vërtetuar nga shkresat e lëndës si tërësi, por posaçërisht nga deklarimi i të dëmtuarit [H.K], dëshmitarëve [Z.B] e [B.D], si dhe nga deklarimi i të akuzuarit [A.A] se i ka vendosur granatat me kërkesën e [SH.Z] dhe njëfarë [B.K] nga Malisheva.”

68. Gjykata rikujton se përmes aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjykata e shkallës së parë ishte bazuar vetëm në deklaratën e të akuzuarit A.A., duke theksuar se “Kolegji penal pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se [B.K] e [SH.Z], kanë angazhuar të akuzuarin [A.A] në vendosjen e granatave të dorës e bombolave të gazit, këtë gjykata e ka vërtetuar nga deklaratimet e dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje penale dhe nga administrimi i provave materiale. [...]”

69. Tutje, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme ishte pajtuar me arsyetimin dhënë nga gjykatat e shkallës më të ulët, në rastin e parashtruesit të kërkesës, duke vlerësuar se (i) ishin dhënë arsye të mjaftueshme për provat mbi bazën e të cilave ishte vërtetuar se ai kishte kryer veprën penale në fjalë; (ii) se veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve B.K dhe A.A., përbënin të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Detyrimi” mbetur në tentativë; (iii) arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore përmbante analizë të hollësishme të çështjeve siç ishin “grupi”, “mjeti i rrezikshëm”, “tentativa” dhe “motivi” dhe se (iv) Gjykata Themelore i kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në shqiptimin e dënimit për parashtruesin e kërkesës. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se deklarata e të pandehurit A.A., nuk është dashur të merret si provë, në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme u konstatua si në vijim:

“Nga aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, por edhe nga shkresat tjera të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se mbrojtja e të dënuarit [A.A] nuk ka qenë e vetmja provë mbi bazën e të cilës është vendosur që të zgjidhet kjo çështje juridike penale. Përkundrazi, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë rast gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar një numër i konsideruar i provave të propozuara nga palët, siç janë: raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, pas hedhjes së granatave të dorës dhe bombolave të gazit në datat 25.05.2010 dhe 07.09.2010, në zyrat e kompanisë së të dëmtuarit; fotot

nga vendi i ngjarjes; provat tjera materiale siç janë: dokumentet e ndryshme, regjistrat, marrëveshjet, fletë-deponimet, vërtetimet, etj.; deklaratimet e të dëmtuarit [H.K], deklaratimet e dëshmitarëve [B.D] dhe [Z.B], etj. Gjithashtu, në këtë aspekt, është e rëndësishme të potencohen edhe video-incizimet e emisionit “Biznesi i Bombave” i “Kallxo.com”, si dhe audio-incizimi i bërë nga i dëmtuari [H.K], të cilat janë administruar si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor [...].”

70. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallës më të ulët kanë adresuar dhe u janë përgjigjur pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes ankesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka arritur në këtë përfundim pasi që ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore kur parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën e kryer penale, ankesën e tij dhe të Prokurorisë Speciale të parashtruara në Gjykatën e Apelit, arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit si dhe kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të dorëzuar pranë Gjykatës Supreme.
71. Prandaj, Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit janë arritur pas shqyrtimit të argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme plotëson të gjitha standardet e nevojshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.
72. Gjykata rikujton gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26).
73. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, në refuzimin e një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatave më të ulëta, në këtë rast Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore (shih, rastin e GJEDNJ-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26). Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore për sa i përket parashtruesit të kërkesës.
74. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërliken me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, rastin e GJEDNJ-së [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit

1988, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 9 majit 2019, paragrafi 42).

75. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e të drejtës materiale dhe vërtetimin e gjendjes faktike (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 61; [Buzescu kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 63; dhe rastin e Gjykatës [KI194/18](#), parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 107). Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallës më të ulët e kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
76. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

(ii) Lidhur me pretendimin për interpretim qartazi arbitrar të ligjit

77. Për sa i përket pretendimit për interpretim qartazi arbitrar të ligjit, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme ka interpretuar në mënyrë të gabuar dhe qartazi arbitrar paragrafin 5 të nenit 123 të KPPRK-së, pasi që sipas kësaj dispozite nuk është dashur që të merret si provë deklarata e të bashkëpandehurit A.A., kundër tij dhe se Gjykata Themelore ka interpretuar gabimisht ligjin kur konstatoi se parashtruesi i kërkesës dhe dy të pandehurit e tjerë kishin vepruar në cilësi të grupit - si anëtarë të grupit, pa bërë dallimin ndërmjet “grupit kriminal” dhe “bashkimit kriminal”.
78. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “*kushtetutshmërisë*” dhe “*ligjshmërisë*” duke theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues *Limak Kosovo International Airport Sh.A. “Adem Jashari”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 majit 2019, paragrafi 55; dhe [KI110/19](#), parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafi 40).
79. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28; dhe shih rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues *Limak Kosovo International Airport Sh.A. “Adem Jashari”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 majit 2019, paragrafi 56 dhe [KI94/22](#), parashtrues *Vejsel Rugova*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 tetorit 2022, paragrafi 64).

80. Gjykata, megjithatë, thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të përvetësuar nga Gjykata, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerri masa kur vëren se një gjykatë ka zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc., kundër Portugalisë*, nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83, *Beyeler kundër Italisë*, nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 108; dhe shih rastin e Gjykatës *KI122/16*, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 59).
81. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se paragrafi 5 i nenit 123 (Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë) i KPPRK-së përcakton se: *“Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit.”*
82. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se, Gjykata Supreme, në arsyetimin e aktgjykimit të saj kishte konstatuar se kjo deklaratë nuk kishte qenë e vetmja provë mbi bazën e të cilës është zgjidhur çështja penale në fjalë. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme iu referua aktgjyqimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, respektivisht provave që i kishin shqyrtuar, siç ishin raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, fotot nga vendi i ngjarjes, deklaratimet e të dëmtuarit H.K., deklaratimet e dëshmitarëve B.D. dhe Z.B., audio-incizimit të bërë nga i dëmtuari, etj.
83. Ndërkaq, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore ka interpretuar gabimisht ligjin kur konstatoi se parashtruesi i kërkesës dhe dy të pandehurit e tjerë kishin vepruar në cilësi të grupit duke mos bërë dallimin ndërmjet “grupit kriminal” dhe “bashkimit kriminal”, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në arsyetimin e aktgjykimit të saj kishte theksuar se neni 107 i KPPK-së nuk ka përcaktuar se çka nënkuptohet me fjalën grup ndërkaq që sipas legjislacionit penal të vënë në fuqi pas KPPK-së, fjalorëve dhe aspektit teorik të shprehjes grup, kjo e fundit nënkupton tre e më shumë persona.
84. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore vlerësoi se: *“Për veprën penale të detyrimit nga neni 267 paragrafi 2 të KPPK, respektivisht vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit [B.K.], [SH.Z.] e [A.A.], ka përcaktuar kryerjen e veprës penale si grup, pra vetëm si grup i tre personave e jo grup i organizuar kriminal.”*
85. Më tej, Gjykata vëren se me konstatimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, lidhur me kryerjen e veprës penale si grup u pajtuan Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, të cilat konstatuan se veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe të bashkëpandehurve tjerë përbënin të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Detyrimi” e mbetur në tentativë, nga paragrafi 2 i nenit 267 lidhur me nenin 20 të KPPK-së.
86. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se si interpretimi i ligjit nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Themelore është qartazi i gabuar apo arbitrar dhe të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” për të.
87. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për interpretim qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit i përkasin kategorisë së pretendimeve “të

shkallës së katërt” dhe të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

88. Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor dhe mos-shqyrtimit të duhur dhe të plotë të rastit i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura dhe të paarsyetuara*” ndërkaq pretendimet për interpretim arbitrar të ligjit i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të shkallës së katërt*”. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 16 korrik 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani